Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**26.10.2023**	**01.11.2023**	**2023/0809**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.10.2023, OE "TSR SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0809, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "TSR SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me targa per regjistrimin e automjeteve" me nr. të prokurimit: "214-22-12927-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0809 i dt:18.10.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 10 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 11 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së pasi që gjatë administrimit të procedurës së prokurimit për "Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve" nuk ka luajtur rol aspak aktiv që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike. Kjo ka ndodhur pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka respektuar kërkesat e vendosura tek dosja e tenderit, kërkesat e modifikuara para hapjes publike përmes sqarimeve dhe nuk i ka cilësuar si duhet dhe në përputhje me LPP-në mangësitë në ofertat e tenderuesve. Si pasojë e kësaj vjen deri te shkelja ku AK përkatësisht Zyrtari Kryesor i Prokurimit shpërblen me kontratë një OE të papërgjegjshëm dhe me çmimin më të lartë se ne. Ne përpos që kishim çmimin më të ulët për 171,575.36€ në krahasim me Grupin e shpallur fitues, ishim edhe kompania me çmimin më të ulët dhe e përgjegjshme në të gjitha aspektet sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Krejt këto veprime e shtyjnë AK drejt shkeljes së nenit 1 të LPP-së lidhur me mos shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë të drejtë, efikase dhe transparente.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që shihet qartë se ka favorizuar kompaninë e shpallur fituese dhe na ka diskriminuar neve si kompania me çmimin më të ulët dhe që i kishim plotësuar të gjitha kërkesat e AK-së. Kjo ka ndodhur si pasoj e asaj që gjatë vlerësimit AK nuk i ka respektuar kërkesat e veta të dosjes ku edhe përkundër

5/26

mangësive në dokumentacion dhe specifika teknike, e trajton si të përgjegjshme ofertën e Grupit të OE "EGO ELSA SHPK & Rade Koncar - kontaktori i relei d.o.o.", ndërsa neve edhe pse i plotësonim të gjitha kërkesat dhe kishim çmimin më të ulët, na eliminon si të papërgjegjshëm. Kjo tregon haptazi se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së duke bërë trajtim jo të barabartë të tenderuesve.

Pretendimi 3. AK ka shkelur nenin 10 të LPP-së pasi që edhe përkundër kërkesës tonë për

qasje në dokumentet e tenderit të Grupit të OE që AK e ka shpallur fitues, kjo e fundit na e ka mundësuar vetëm qasjen e limituar duke u thirrur në një Kërkesë për Sekret Afarist të këtij Grupit të OE i cili ka kërkuar që të mbeten sekret Raportet Financiare, Test Raporti nga laboratori, Certifikata për folinë dhe ngjyrën e shkronjave si dhe ISO certifikatat. Veprimi i tillë i AK-së konsiderohet shkelje dhe mos transparencë totale sidomos kur dihet që kërkesa për sekret afarist nuk ishte e plotësuar saktë sipas nenit 11.3 të LPP-së. Ja si

duket një pjesë e kësaj deklarate që tregon kush duhet mbetur sekret dhe cili është impakti.

DUKE PASUR PARASYSH SE *[EGO ELSA SHPK]* (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Raportet financiare, Test raporti nga laboratori,Akreditimi i laboratorit, Certifikata per folin dhe ngjyren e shkronjave , ISO certifikatat,

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

Qasja publike ne dokumentacionin e lartecekur do te rezultonte ne demtimin material te interesave legjitime komerciale te prodhiesit.Gjithashtu dokumentet e lartecekura bejne pjese ne dokumentacionin i cili mund te klasifikohet si sekret afarist bazuar ne LLP.

Nga kjo po shihet se kërkesa ishte vetëm për dokumente që nuk janë pronë e OE dhe se arsyetimi i dëmit që do shkaktohet nga zbulimi i informatave të tilla nuk është dhënë fare. Nga ky arsyetim shihet se ky Grup i OE nuk e ka plotësuar këtë dokument si duhet sepse nuk ka dhënë fare arsyetim sipas kërkesës së nenit 11.3.3 të LPP-së andaj kur formularët e tillë nuk plotësohen si duhet sipas LPP-së, të njëjtit nuk duhet pranuar nga AK-ja. Bazuar në nenin 11.3 të LPP-së, AK duhet ta konsideroj një informatë si sekret afarist vetëm nëse plotësohen tre kushtet e këtij neni prandaj mos lejimi i qasjes në dokumentacionin e kërkuar nga ne ka rezultuar në shkelje të plotë të nenit 10 të LPP-së nga ana e AK-së. Ja edhe dëshmitë që ne kemi kërkuar dy here qasje në dokumente dhe AK nuk na ka dhënë qasje

ashtu siç e parasheh ligji:

Datë:28.09.2023

Për: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME– Departamenti i prokurimit**

Nga: **TSR SHPK**

Marksim Malsijaj

Lënda: **Kërkesa për qasje në dokumentacionin e tenderit: "Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteveNr1 i prokurimit 214-22-12927-1-1-1,Nr i brendshëm 214-22-121-1-1-1**

Të nderuar/a,

Me datë 28.09.2023 jemi njoftuar me Vendimin e AK-së ku sipas Letrës standarde jemi njoftuar se jemi cilësuar si tenderues i përgjegjshëm gjatë vlerësimit te tenderëve për procedurën e prokurimit në fjalë

Bazuar në nenin 10 të LPP-së mbi të drejtën e OE për qasjen në dokumentacionin e tenderit, KËRKOJMË që në afat sa më të shpejt dhe në formë të papenguar të na lejohet qasja në dokumentacionin e OE fitues

.Perfaqsuesi i ynë Z.Marksim Malsijaj Do te vije qe te ket qasje ne dukomentacion me dat 29.09. 2023 ne oren 8;30, ne te kunderten ju lutemi që të na caktoni kohën kur mundemi të kemi qasje në dokumentet e tenderit sepse është e rëndësishme që të kemi informata të sakta lidhur me procesin e vlerësimit nga çka edhe varet vazhdimi apo jo me procedurat e kontestimit të vendimit të AK-së.

Dukomentat qe kerkojm te kemi qasje ne dukomentacion;

Te gjitha dosjen e OE fitues, veqanarisht certifikatat ; pastaj test rapotet sipas specifikacjoneve teknike te cilat heren e fundit na u kan mohuar me arsytim se jan dukomente Konfecialitet, raportet e te gjitha Komisjoneve te vlersimit ,raportin e forezikes dhe fakulltetit Pastaj kerkojm ta shofim Mostren e OE FITUES te gjitha keto matrejalet Te na derzoni ne UBS te cilen do ta sjellim

Me respekt,

Marksim Malsijaj

TSR SHPK

Republika e Kosoves
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Prishtinë: 28.09.2023

Autoriteti Kontraktues: **MPB – Divizioni i Prokurimit**
Adresa: Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

Adresa e tenderuesit: Grup i Operatorëve Ekonomik, **"TSR" SH.P.K.; & "EHA Hoffmann International"** GmbH

Nr. i Prokurimit	214-22-12927-1-1-1

TSR SHPK

Titulli: "Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve"

FTESË

Në pajtueshmëri me Nenin 10 të LPP-së, në bazë të kërkesës nga ana e Juaj, Ju ftoj për qasje në dokumentet e tenderin: Titulli: **"Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve"** *me nr. të e-prokurimit: 214-22-12927-1-1-1.*

Për qasje në dokumentet për tenderin e lartë cekur, mund të vini në **MPB,** Adresa: Rr, "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë,

Me datë 29.09.2023 në ora 9:00.

DOSIA E TENDERIT TE OE FITUSE I DERZOHET
OE TSR - SHPK JO E PLOT
1. MUNGOJN TEST RAPORTET - TE CICAT JAN KORRIGJUAR
SJALL DHE ~~NUK~~ NE QASJEN NE DUKUMENTACIONI
NUK NA DORZOHET AS TE PERMISUMI
2. MUNGON CERTIFIKATA ISO 7591 PER FOLIETIN
ZEZ E CILA NUK NA DORZOHET AS E PLOT
AS E PASTRUAR SIPAS NENIT 11 TE LPP

Për: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME – Departamenti i prokurimit**

Nga: **TSR SHPK - Marksim Malsijaj**

Lënda: **Kërkesa për qasje në dokumentacionin e tenderit: "Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve Nr1 i prokurimit 214-22-12927-1-1-1, Nr i brendshëm 214-22-121-1-1-1**

Të nderuar/a,

Me datë 28.09.2023 jemi njoftuar me Vendimin e AK-së ku sipas Letrës standarde jemi njoftuar se jemi cilësuar si tenderues i pa-përgjegjshëm gjatë vlerësimit te tenderëve për procedurën e prokurimit në fjalë

Bazuar në nenin 10 të LPP-së mbi të drejtën e OE për qasjen në dokumentacionin e tenderit, Me daten 29.09.2023 ne oren 9.15 fillon procedura ne qasjen e dokomentacionit dhe verifikimit te modelit te targa e OE qe AK e ka shpallur fitues.

Me ket rast edhe pse ne kemi bere kerkesen me shkrim sipas LPP-se per qasje ne tere dokumentacionine tenderit, neve nuk na dorzohen dukomentacionet e plota te OE tpe shpallur fitues. Aty mungojne Test raportet e targes RKS 520x110, TR te Folies se Zeze, TR te Folies se bardhe reflektuese, TR te Folies se gjelber, TR te Aluminit dhe mungon certifikata ISO 7591 per Foljen e zeze te nzehte per numra dhe shkronja. Keto ishin kerkesa sipas pikes (Nr 10 te DT e ku kerkohej qe: **Furnizuesi obligohet të bashkangjitë certifikata dhe dëshmitë që prodhuesi i targës i plotëson standardet e poshtëshënuara** dhe keto te gjitha te leshuara nga nje laborator i akredituar. Sipas dakordimit me zyrtar pran zyres se prokurimit na u konfirmua qe do te na dergojn deshmite e tilla me E-mail andaj nisur ng kjo kerkojm nga AK qe keto te na dergohen me imeil ne daten 29.09.2023 dhe at me se lagti deri ne oren 16,oo. Keto duhet te dergohen ne formen e plot ose ne formen e Pastruar siq ju obligon edhe neni 11 i LPP-se.

Me respekt,

Marksim Malsijaj

TSR SHPK

Pra edhe pas kërkesës së dytë që të na i dërgojnë këto dokumente, AK nuk na i ka dërguar që është një arsye e plotë me dëshmua se AK ka shkelur nenin 10 të LPP-së.

Pretendimi 4. AK ka shkelur nenin 11 të LPP-së pasi që përpos mos respektimit të paragrafit 3 të këtij neni, nuk e ka respektuar as paragrafin 4 dhe 5 të nenit 11 të LPP-së. Fillimisht i ka konsideruar informatat si sekret afarist pa u plotësuar paragrafi 3 i këtij neni e mandej nuk e ka respektua as paragrafin 4 dhe 5 duke mos përgatitur versionin e pastruar të dokumenteve. Edhe pse në dosje të tenderit AK e kishte vendosur deklaratën në përputhje

me paragrafin 6 të nenit 11 të LPP-së, vet AK dhe Grupi i OE nuk e kanë respektuar këtë

9/26

detaj andaj konsiderohet se fshehja e informatave të tilla duke u thirrur në një deklaratë që nuk është e plotësuar si duhet sipas nenit 11.3 të LPP-së konsiderohet shkelje e plotë. Ligjërisht informatat e tilla nuk e plotësojnë asnjë nga kushtet për tu cilësuar si informata sekrete afariste prandaj edhe konstatojmë se AK nuk e ka respektuar nenin 11 të LPP-së. Edhe përkundër kërkesës tonë të përsëritur dy herë që të pajisemi me materialin e pastruar të tenderit, AK prap nuk e respekton kërkesën tonë dhe atë të ligjit dhe nuk na jep dokumentet e tilla. Dëshminë e kësaj e gjeni të bashkangjitur në e-prokurim. Edhe arsyetimi i pabazuar i AK-së tek refuzimi i pretendimit tonë se gjoja ata kanë vepruar sipas Rregullores RRPP□001/2022 nuk qëndron se neni 7.6 i kësaj rregulloreje e përcakton qartë se çka konsiderohet

sekret afarist dhe kur duhet pranuar një kërkesë e tillë. Mjafton të shihet kërkesa për sekret afarist dhe të krahasohet me nenin 11 të LPP-së dhe nenin 7 të RRPP-001/2022 nga ku nxirret lehtë konkluzioni se AK ka shkelur të dy këto dispozita. Ja si e përshkruan detyrimin e AK-së kjo rregullore:

7.6 Informacionet mund të klasifikohen si konfidenciale vetëm nëse:

a. Operatori Ekonomik, përveç se i identifikon ("markon") dokumentet si "sekret afarist" gjatë ngarkimit të tyre në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, i njëjti duhet të plotësojë Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit *"Kërkesa për sekret afarist"*.
b. Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi *Aneksin 3 "Kërkesa për sekret afarist"*, të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të idetifikuar si "sekret afarist", nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij.

Nisur nga kjo, ne kërkojmë nga OSHP që të i trajtoj detalisht këto dokumente që ne nuk i kemi pasur në shikim por që kemi bindje të fortë se ato nuk janë në rregull ku gjithashtu të nxirret vendim që AK ka shkelur nenin 11 të LPP-së.

Pretendimi 5: AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka respektuar kërkesat e paragrafit 4 të këtij neni. Neni 59.4 i LPP-së e thotë

qartë se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Arsyeja pse pretendojmë se AK ka bërë këtë shkelje të nenit 59 të LPP-së është se gjatë vlerësimit të tenderit që e ka shpallur fitues nuk i ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit

siç janë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	2.Operatori ekonomik është i obliguar që për targat me të cilat ofertojnë duhen ta dorëzojnë një mostër të targës së rëndomtë e cila është në përdorim, me dimensione 520 x 110 mm së bashku me përshkrimin e specifikimeve teknike. Nëse nuk dorëzohet mostra dhe përshkrimi i specifikimeve teknike te mostrës oferta nuk do te merret ne shqyrtim dhe do te konsiderohet oferte e pa përgjegjshme. Mostra nuk është e obligueshme që ti kenë masat e veçanta të sigurisë, por duhet jenë ne harmoni me kualitetin e materialeve për prodhimin e targave sipas specifikave teknike te dhëna ne Aneksin 1 të Dosjes së tenderit.	2. Një mostër të targës me dimensione 520 x 110mm, sipas specifikimeve teknike-MOSTRA e targave dorëzohen fizikisht para hapjes se ofertave, në një zarf të mbyllur.
		3. Test Raport nga Laboratori apo instituti i autorizuar i cili, duhet te dëshmoj që prodhimi i targave (mostrave) për regjistrim te automjeteve dhe karakteristikat teknike te targave janë në përputhje me standardet ISO 7591 dhe specifikimeve teknike te dosjes se tenderit.	3. Dëshmi e lëshuar nga laboratori apo instituti i autorizuar (kopje), *AK rezervon te drejten qe te kerkoi origjinalin e dokumentit me nese e konsideron te nevojshme*)
		5.Dëshmi me të cilën dëshmohet që folia dhe ngjyra e shkronjave është kompatibile në pajtim me ISO 7591.	5.Çertifikatë ose dokument tjetër dëshmues (kopje), *AK rezervon te drejten qe te kerkoi origjinalin e dokumentit me nese e konsideron te nevojshme*).

Lidhur me këtë tek specifikimi teknik ka qenë edhe kërkesa:

4.1 Shiritat me ngjyrë të zezë për shkronja dhe numra, detyrimisht duhet të kenë shenjen RKS të përsëritur periodikisht në të gjithë gjatësinë dhe gjerësinë e tyre .

Orientimi i shenjës RKS do të bëhet në linjën, në këndin 45 shkallë me konturat e shiritit në distancë 4.0 mm dhe 5.5 mm nga njëra tjetra.

Ngjyra e shenjave duhet të jetë e zezë, por me nuancë të ndryshme nga ajo e shiritit.

Për ta vërtetuar këtë mos përputhje, mundeni të i shikoni mostrat e ofruara nga ky Grup i OE dhe të i kërkoni që të ju sjellë një foli të tillë e cila do duhej trajtuar bashkërisht edhe në seancën e hapur që do mbahet tek shqyrtimi kryesor në OSHP. Nga aty do të shihet qartë se a e plotësojnë kërkesën e AK-së që ndodhet tek pika (9.1&9.2).2 e FDT, tek pika 4 e Aneksit 1. Ne gjithashtu kërkojmë një super ekspertizë të mostrës në ndonjë laborator të tretë të akredituar dhe kredibil për këtë qëllim sepse raporti i tillë nuk është respektuar nga AK edhe pse i kishte evidentuar këto të meta në mostrën e tijë.

Kërkesa tjetër te pika (9.1&9.2).3 e FDT-së ishte që për tabelën e dhënë të dorëzohet Test Raporti nga Laboratori apo instituti i autorizuar të cilën sipas pohimeve të AK-së ky Grup i OE e ka dorëzuar por që neve nuk na është dhënë në shikim. Po që se shikohet me vëmendje, me vet faktin që tabela e tillë nuk posedon shiritat e zi të punuar në të nxehtë sipas kërkesës së AK-së, tregon hapur se edhe Test Raporti nuk është në rregull dhe nuk është punuar në përputhje me kërkesën e AK-së. Këtë dokument nuk na e ka ofruar AK për shikim andaj ne dyshojmë se ky raport nuk është dorëzuar fare, apo edhe nëse është dorëzuar, i njëjti posedon mangësi të mëdha për të cilat nuk do duhej pranuar si i rregullt.

Nisur nga kjo kemi arsye të mendojmë se ky Grup i OE për mungesë të këtij raporti (Test Raporti për Targën RKS 01-999-AD) do duhet cilësuar si i papërgjegjshëm. Ne jemi të bindur se raporti i tillë nuk është në rregull ose mungon fare andaj kërkojmë nga OSHP që ta trajtoj më saktë këtë mangësi tek tabela dhe tek Test Raporti ku pas kësaj ta aprovoj pretendimin tonë si të bazuar dhe grupin e tillë të OE-ve ta cilësoj të papërgjegjshëm.

Nga kjo shihet se edhe deklarata e dhënë nga ky grup i OE se gjoja i plotësojnë kërkesat e specifikimeve teknike shihet të jetë e rrejshme sepse folia e paraqitur nga ky Grup i OE nuk është sipas kërkesave të AK-së dhe të dosjes së tenderit.

Ne posedojmë një Test Raport me nr. 144920228 të OE Rade Koncar - kontaktori i relei

d.o.o. të siguruar nga një procedurë tjetër e prokurimit e që besojmë shumë se e njëjta është dorëzuar edhe te kjo procedurë po që AK nuk na ka lënë ta kemi si dokument.

Ky test raport shihet se është lëshuar nga Kompania DEKRA dhe ne kërkojmë nga eksperti shqyrtues që pretendimin tonë ta vërtetoj edhe vet dhe të ju drejtohet Laboratorit të akredituar DEKRA apo personit kontaktues CHRISTJAN Warken me E-Mail: christian.warken@dekra.com dhe Telefon +49 681 500180.

Eksperti shqyrtues kërkojmë që të bëjë pyetje se çfarë ka testuar OE Rade Koncar kontaktori i relei d.o.o. ne testraportin qe ka prezantuar e qe ne pretendojmë se është test Certifikata lëshuar ne emër te RADE Korçar me nr. 14492022. Pastaj të kërkoj një raport boletin të detajuar dhe të shikoj a janë testuar produktet e cekura tek pika 10 e dosjes së tenderit apo specifikat teknike. Ne e kërkojmë këtë pasi që gjatë bisedës që kemi pasur me z.Warken, ky na konfirmon që është testua tabela mostër NMK (Nord Makedonijen dhe ky e konfirmon se disponon edhe dëshmitë me foto të targave dhe se nuk është testua targa e RKS siç pretendon AK. Këto dëshmi kompania DEKRA i ofron vetëm nëse kërkohen nga Institucione kredibile dhe relevante siç është OSHP në rastin e tillë. Pra kërkojmë nga eksperti shqyrtues që ta verifikoj saktë testraportin e paraqitur nga OE Rade Koncar - kontaktori i relei d.o.o. sepse ne dyshojmë që nuk është testuar fare tabela 01-999-AD pasi që këtë na e ka konfirmua përmes telefonit personi kontaktues nga laboratori. Ja si duket certifikata e tillë që ne besojmë se e njëjta është dorëzuar në këtë tender:

DEKRA

Test certificate

It is hereby confimed that

RADE KONCAR Kontaktori I Relei D.O.O.
3ta Makedonska Brigada No. 54
1000 Skopje
Republic of North Macedonia

fulfills the requirements according to ISO 7591:1982 for vehicle licence plates.

The test certificate was produced as a result of product testing.
Detailed results can be found in the corresponding test report no. 14492022.

The following motor vehicle licence plates were tested:

Dimensions	Reflective sheeting	Hot stamp foil	Quality plates	Thickness plates
520 x 110 mm	3M Series 4750	Black	Aluminium EN AW-1050	1 mm

Saarbrücken, 04.11.2022

DEKRA Automobil GmbH

Dipl.-Ing. Christian Warken
Specialist department

DEKRA Automobil GmbH
Handwerkstraße 15
D-70565 Stuttgart
Telefon +49.711.7861-0

Telefax +49.711.7861-2240
www.dekra.com

Sitz Stuttgart, Amtsgericht Stuttgart,
HRB-Nr. 21039
Bankverbindungen:
Commerzbank AG

IBAN DE84 6008 0000 0001 0001 00 / BIC DRESDEFF600
BW Bank
IBAN DE74 6009 0101 0002 0195 35 / BIC BOLADE8TXXX

Vorsitzender des Aufsichtsrates:
Stefan Köbl
Geschäftsführer:
Guido Kutschera (Vorsitzender)

Friedemann Bausch
Jörn Fohlsauer

Tek pika (9.1&9.2).5 e FDT-së AK kishte kërkuar që OE të ofrojnë certifikatën ISO 7591 të cilën si kërkesë të FDT-së e kishte larguar përmes sqarimeve. Pavarësisht kësaj e njëjta kërkesë ka mbetur aktive të pika 10 e Aneksit 1 ku si kërkesë AK e kishte vendosur kështu:

Materiali që kërkohet	Dokumenti që kërkohet	Kërkesa
Shtresë me stampim të nxehtë	Certifikata dhe test raporti i adresuar në prodhuesin e tabelës së regjistrimit në pajtim me standardet ISO 7591 i lëshuar nga një laborator i akredituar.	Shtresë me stampim të nxehtë në pajtim me fletën retroreflektive dhe të dyja në pajtim me ISO 7591, pjesa 8, 12, 13, 14 dhe 15.

Ky Grup i OE, me që shihet hapur se mostrën e ka dorëzuar me mangësi dhe pa shiritin e tillë i cili stampohet në të nxehtë, atëherë lind dyshimi se të njëjtëve u mungon edhe dëshmia që këta shirita janë në përputhje me standardin ISO 7591. Me që AK nuk na ka dhënë qasjen në këtë certifikatë, ne dyshojmë se ajo nuk ishte në përputhje me kërkesat dhe nisur nga kjo kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues që ta rishikoj edhe një here vërtetësinë e sajë. Ne mbetemi të bindur se ajo nuk i plotëson kushtet e kërkuara ose mundet edhe të mungoj fare. Për mungesën e sajë apo parregullsinë e të njëjtës, AK duhet ta cilësoj këtë Grup të OE si të papërgjegjshëm.

Pra për mungese të mosplotësimit të këtyre kërkesave nga FDT-ja shihet qartë se ky Grup i OE është dashur të cilësohet si i papërgjegjshëm.

Ky Grup i OE ka edhe mangësi tjera tek plotësueshmëria e kërkesave të specifikimeve teknike sipas Aneksit 1. Mangësitë e tilla janë kryesisht tek pika 10 e Aneksit 1. Kërkesat e tilla të vendosura tek kjo tabelë duken kështu:

10. Furnizuesi obligohet të bashkangjitë certifikata dhe dëshmitë që prodhuesi i targës i plotëson standardet e poshtëshënuara.

Materiali që kërkohet	Dokumenti që kërkohet	Kërkesa
Prapavija me fletë të bardhë retroreflektuese	Raporti testues i adresuar në prodhuesin e fletës retroreflektuese	Rezultate pozitive në pajtim me ISO 7591
Shtresë me stampim të nxehtë	Certifikata dhe test raporti i adresuar në prodhuesin e tabelës së regjistrimit në pajtim me standardet ISO 7591 i lëshuar nga një laborator i akredituar.	Shtresë me stampim të nxehtë në pajtim me fletën retroreflektive dhe të dyja në pajtim me ISO 7591, pjesa 8, 12, 13, 14 dhe 15.
Alumin	Raport testues adresuar në prodhuesin e tabelës në pajtim me standardin ISO 7591 nga laboratori i akredituar.	Rezultati pozitivë në pajtim me ISO 7591 Alumin EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42, shtresa mbrapa aluminit të targës të jetë e mbrojtur me llak transparent.
Mostra sipas standardit ISO 7591- Fletë e bardhë retroreflektuese së bashku me vijat virtuale të sigurisë dhe shenjat drejtuese të sigurisë	Raport testues i adresuar në prodhuesin e tabelës së regjistrimit në pajtim me standardin ISO 7591i lëshuar nga laboratori i akredituar,	Rezultate pozitive në pajtim me standardin ISO 7591
Mostra sipas standardit ISO 7591- Fletë e gjelbër retroreflektuese.	Raport testues i adresuar në prodhuesin e tabelës së regjistrimit në pajtim me standardin ISO 7591i lëshuar nga laboratori I akredituar,	Rezultate pozitive në pajtim me standardin ISO 7591

Mangësitë tek shtresa me stampim në të nxehtë i cekëm më lartë.

Duke ju referuar gjithnjë Test Raportit që AK nuk na ka dhënë qasje në të, besojmë se ky Grup i OE nuk ka arritur ta plotësoj kriterin e kërkuar që shtresa mbrapa aluminit të targës të jetë e mbrojtur me llak transparent. E themi këtë sepse në Test Raportet e siguruara nga ne që OE Rade Koncar-kontaktori i relei d.o.o ka dorëzuar në procedurat tjera të prokurimit në vendet fqinje siç është TEST CERTIFICATE me no. 14492022 të lëshuar nga Dekra Saabrucken, i mungon kjo e dhënë. Lidhur me këtë ne besojmë se Test Raportin e njëjtë e ka dorëzuar edhe në këtë proces të prokurimit e që i njëjti nuk e plotëson këtë kriter. Dyshimin dhe besimin se ky raport dhe ky kriter nuk janë në rregull tek tenderi i Grupit të OE që AK e ka shpallur fitues na e shton fakti që AK nuk na ka dhënë mundësinë ta shohim Test Raportin e tillë. Plotësimi i këtij kriteri do duhej konfirmuar tek Test Raporti me tekstin që tregon se Alumini posedon mbrapa shtresën me llak transparent për mbrojtje.

Në Test raportin që OE Rade Koncar-kontaktori i relei d.o.o e kishte dorëzuar në procedura tjera e që besojmë se të njëjtin e ka dorëzuar edhe këtu, nuk shihen fare të dhënat për testimin e Foljes së bardhë dhe foljes së gjelbër reflektuese e gjithashtu as të targës RKS. Këto ishin kërkesa decidive të Aneksit 1 (shih tabelën sipër) të cilat do të duhej të dëshmoheshin me Test Raport për tabelën RKS. Ky test raport gjithsesi do duhej të ishte në emër të prodhuesit të targës e që ne dyshojmë se Grupi i OE i shpallur fitues nuk e posedon fare ose nuk e posedon si të rregullt me të dhënat e kërkuara nga AK. Ne kërkojmë që të rishikohet dhe verifikohet edhe një here Test Raporti i tillë nga eksperti ku besojmë shumë se do të rezultojë me papërgjegjshmërinë e grupit të OE në fjalë. Po ashtu kërkojmë nga OSHP që ta detyroj Grupin e OE të shpallur fitues që në seancën e shqyrtimit kryesor të sjellë një mostër të folisë së zezë që e ka aplikuar në tabelën e dorëzuar si mostër tek AK me të cilën i ka mbuluar shkronjat dhe numrat e zi. Ndërsa nga AK të kërkoj që ta sjellë mostrën të cilën ky Grup i OE e ka dorëzuar me rastin e tenderimit. Kjo të bëhet për qëllim të verifikimit në seancë se a i plotëson tabela e tillë kushtet e kërkuara nga AK, sidomos ato që vërehen me syrin e lirë.

Krejt këto veprime të kundërligjshme e shtyjnë AK-në drejt shkeljes së nenit 59 të LPP-së ndërsa mangësitë e tilla e bëjnë Grupin e OE që AK e ka shpallur fitues plotësisht të papërgjegjshëm.

Përpos krejt këtyre mangësive që i cekëm më lartë, ekzistojnë edhe mangësi tjera që i kemi evidentuar tek raporti i forenzikës të cilat tregojnë për mospërputhje të mostrës me kërkesat e kërkuara në dosjen e tenderit por që Zyrtari Kryesor i Prokurimit qëllimisht dhe jashtë ligjshëm i ka fshehur si detaje.

Fillimisht duhet të theksojmë se si kërkesë e AK-së ishte ajo për vijën virtuale. Kërkesa duket kështu:

3. Fija virtuale e sigurisë

Fija virtuale e sigurisë në tabelën regjistruese do të përbëhet nga dy valë horizontale në formë gjarpëruese (sinusoidale) që mbulojnë njëra tjetrën, ku njëra valë paraqitet duke u zbeh nga rrafshi i shtresës reflektuese kurse vala tjetër është e vonuar dhe paraqitet duke qenë pezull përmbi. Toleranca për gjatësinë mund të jetë 34mm+/-3mm, ndërsa toleranca për gjërsinë 10mm +/-1mm.



Sipas raportit të forenzikës shihet se ky kusht nuk ishte plotësuar nga mostra me shifrën 444 e që i përkiste Grupit të OE "EGO ELSA SHPK & Rade Koncar - kontaktori i relei d.o.o.". Ja si duket matja dhe konstatimi i Forenzikës:

3. Fija virtuale e sigurisë:

Fija virtuale e sigurisë është prezent dhe pas matjeve rezulton:	Standardi sipas kërkesës me nr. 118
Gjerësia 8.47 mm	10 mm me tolerancë +/-1 mm
Gjatësia mesatare 33.38 mm	34 mm me tolerancë +/-3 mm

Pra me që dimensioni i gjerësisë së vijës virtuale ishte kërkuar të jetë 10mm±1mm ndërsa dimensioni i matur tek tabela e tillë është 8.47mm, tregon mjaftueshëm se ku kriter nuk ishte plotësuar siç kërkohej nga AK.

Sipas skicës dhe parametrave të targës ishte kërkuar edhe ajo që targa të ketë në anën e majtë imazhin numerik të mbishkrimit RKS. Ja si dukej kjo kërkesë:



Sipas raportit të forenzikës faqe 20 shihet se kjo nuk ishte plotësuar nga targa me shifrën 444 dhe se deklarimi i forenzikës duket kështu:

- **Në anën e majtë të targës nuk pasqyrohet imazhi numerik i mbishkrimit "RKS".**

Faqe 20 nga 40

Agjencia e Kosovës për Forenzikë, Adresa: Bulevardi "Bill Clinton" Zona industriale 1, 10000 Prishtinë – Kosovë, Tel: +381(0)38/603-610 & 603-609, Fax: +381(0)38/603-608, E'mail: agjenciaforenzikes@rks-gov.net;

Vlen të thuhet se edhe ky detaj dhe kjo mangësi ishte fshehur nga Zyrtari Kryesor i Prokurimit dhe ishte anashkaluar qëllimisht gjatë vlerësimit të Grupit të OE të shpallur fitues.
Gjatë qasjes në dokumentacionin e tenderit dhe shikimin e mostrave, vërehet se targa e cila më pas ishte dërguar për ekzaminim edhe në fakultetin teknik, për çudi e posedon imazhin numerik të mbishkrimit RKS në anën e majtë. Kjo len vend për të dyshuar se gjatë procesit të vlerësimit dhe ekzaminimit të mostrave, mostra me shifrën 444 është ndërruar apo ndryshuar me një të re në bashkëpunim me Zyrtarin Kryesor të Prokurimit. Këtë pretendim që ne e kemi paraqitur ne AK përmes Kërkesës për Rishqyrtim, Zyrtari Kryesor i Prokurimit e cilëson të pabazuar dhe tendencioz. Kjo nuk është e vërtetë pasi që ne vetëm po përshkruajmë fakte dhe ndodhi ku shtrohet pyetja se si ka mundësi që tek testimi i tabelës nga forenzika të mos figuroj imazhin numerik të mbishkrimit RKS ndërsa tek testimi nga fakulteti teknik dhe të figuroj. Figurimin e imazhin numerik të mbishkrimit RKS e kemi vërejtur edhe se ekziston në tabelën që e kemi shikuar prandaj kjo len përshtypjen se ose është ndryshuar tabela ose forenzika e ka testuar gabimisht këtë element.

Këtë veprim dhe ndodhi ne veç e kemi paraqitur tek organet e rendit për hetim sepse ndryshimi i fakteve dhe dëshmive të OE gatë procesit të vlerësimit sipas LPP-së është i ndaluar ndërsa sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës konsiderohet edhe vepër penale.

AK pa asnjë bazë ligjore po dëshiron ta shpërblej një Grup të OE i cili është i papërgjegjshëm dhe i pa aftë ta realizoj kontratën e tillë. Se i njëjti nuk i ka kapacitetet për furnizim me targa të tilla e dëshmon edhe fakti që ky Grup i OE përkatësisht anëtari i tyre Rade Koncar - kontaktori i relei d.o.o. akoma pa u shpallur fitues na dërgon kërkesë për ofertë që ne të i furnizojmë me tabela të tilla. Ja si duket kërkesa e tyre dërguar anëtarit të dytë të Grupit të OE që ne e përfaqësojmë:

Von: "Meshkova Nadica" <nadica@radekoncar.com.mk>
An: <s.khatib@eha-group.com>
Gesendet: Mon, 25 Sep 2023 10:17:01 +0200
Betreff: quotation

Dear Sandra,

We inform you that we won the tender for car plates for Kosovo. At the moment , complain procedure is going on and it will take 2 weeks.
Please send me information can you send us offer for licence plates as follows:

License plates reflective white
520.80 x 112.50 (+ - 0.2) x1,0 mm
With RKS graphic, water sign and VST
Without EHA logo
Qty: 285.000pcs

Best regards,

-
Nadica Meshkova
Purchasing Manager
m. s+389 75 266 794
t.sss +389 2 2401 114
a.ss 3rd Makedonska brigade 54 , Skopje, Republic North Macedonia

RADE KONČAR
KONTAKTORI I RELEI D.O.O.
[redacted]
[redacted]

This e-mail and any attachments may contain confidential and/or privileged information and is intended solely for the addressee. If you are not the intended recipient (or have received this e-mail in error) please notify the sender immediately and destroy this e-mail. Any unauthorized use, review, retransmissions, dissemination, copying or other use of this information by persons or entities other than the intended recipient is strictly prohibited.

Ja si duket përgjigja që ne i kemi kthyer:

Betreff:	FW: quotation	**Empfangen:**	25.09.23, 15:56
Von:	Waldemar Ginter (w.ginter@eha-group.com),	**An:**	nadica@radekoncar.com.mk ,
		CC:	Claudia Müller (c.mueller@eha-group.com),

Dear Nadica,
thank you for your request. Please provide us the confirmation that you received the approval to supply the plates to Kosovo.

*** Bitte beachten Sie, dass unser Betrieb am Montag, den 02.10.2023 geschlossen bleibt. ***

Freundliche Grüße / best regards

International Operations - ppa. **Waldemar Ginter**

EHA
Hoffmann International GmbH

Hausanschrift:
Michelsbergstr. 24 • D-57080 Siegen
E-Mail: w.ginter@eha-group.com
Web: www.EHA-group.com

Telefon: +49 (0)271 / 39 32 - 0 • Fax: +49 (0)271 / 39 0337
Sitz der Gesellschaft Siegen • Gerichtsstand Siegen
Amtsgericht Siegen • HR B 5021
Geschäftsführung: Sandra Hoffmann, Jörg Klingelhöfer
USt-ID-Nr. DE 812 594 988

Diese Nachricht ist vertraulich. Sie ist ausschliesslich für den im Adressfeld ausgewiesenen Adressaten bestimmt. Sollten Sie nicht der

Dhe ja si duket edhe kërkesa e dytë e Rade Koncar - kontaktori i relei d.o.o. drejtuar neve:

Gesendet: Tue, 26 Sep 2023 14:56:57 +0200
Betreff: FW: quotation

REMINDER!!

From: Meshkova Nadica <nadica@radekoncar.com.mk>
Sent: Monday, September 25, 2023 10:17 AM
To: 's.khatib@eha-group.com' <s.khatib@eha-group.com>
Subject: quotation

Dear Sandra,

We inform you that we won the tender for car plates for Kosovo. At the moment , complain procedure is going on and it will take 2 weeks.
Please send me information can you send us offer for licence plates as follows:

License plates reflective white
520.80 x 112.50 (+ - 0.2) x1,0 mm
With RKS graphic, water sign and VST
Without EHA logo
Qty: 285.000pcs

Best regards,

-
Nadica Meshkova
Purchasing Manager
m. +389 75 266 794
t. +389 2 2401 114
a. 3rd Makedonska brigada 54 , Skopje, Republic North Macedonia

RADE KONČAR
KONTAKTORI I RELEI D.O.O.
www.radekoncar.com.mk

This e-mail and any attachments may contain confidential and/or privileged information and is intended solely for the addressee. If you are not the

Pra me vet faktin që ky OE ka kërkuar ofertë nga ne, shihet se vet nuk është në gjendje të i prodhoj, siguroj dhe furnizoj tabelat e tilla sipas kërkesave të AK-së dh ei njëjti realisht do duhej cilësuar i papërgjegjshëm.
Me gjithë këto mangësi të këtij Grupi të OE, nuk kemi se si të mos mendojmë se AK e ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe se Oferta e Grupit të OE të shpallur fitues është plotësisht ofertë e papërgjegjshme.

AK nuk ka vepruar sipas nenit 59 të LPP-së edhe kur na ka eliminuar neve nga konkurrenca si tenderues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët. Arsyen pse mendojmë kështu po e japim në vazhdim.

prodhoj, siguroj dhe furnizoj tabelat e tilla sipas kërkesave të AK-së dh ei njëjti realisht do duhej cilësuar i papërgjegjshëm.

Me gjithë këto mangësi të këtij Grupi të OE, nuk kemi se si të mos mendojmë se AK e ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe se Oferta e Grupit të OE të shpallur fitues është plotësisht ofertë e papërgjegjshme.

AK nuk ka vepruar sipas nenit 59 të LPP-së edhe kur na ka eliminuar neve nga konkurrenca si tenderues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët. Arsyen pse mendojmë kështu po e japim në vazhdim.

20/26

Sipas Letrës standarde për tenderuesin e papërgjegjshëm shihet se ne jemi eliminuar për këtë arsye:

1. Tenderi i juaj **është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:**

❑ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenin 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar, sepse gjatë procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit Tuaj, komisioni i vlerësimit ka konstatuar se nuk keni dorëzuar dëshmi të mjaftueshme, si është kërkuar te SEKSIONI II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) në Dosje të tenderit (*kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- Kapaciteti teknik dhe profesional*), nr. i nenit 9.1 & 9.2;

Kërkesa:

3. Test Raport nga Laboratori apo instituti i autorizuar i cili, duhet te dëshmoj që prodhimi i targave (mostrave) për regjistrim te automjeteve dhe karakteristikat teknike te targave janë në përputhje me standardet ISO 7591 dhe specifikimeve teknike te dosjes se tenderit.

Dëshmia:

3. Dëshmi e lëshuar nga laboratori apo instituti i autorizuar (kopje),

Komisioni i ri-vlerësimit ka konstatuar se për kërkesën dhe dëshminë nr. 3 ju keni prezantuar një test report nga MOTOR TRANSPORT INSTITUT me numër 1050/CBM/20222 datës 05.01.2023.

Ne aneksin 1 te dosjes se tenderit pika 10 përveç tjerave është kërkuar:

Alumin	Raport testues adresuar në prodhuesin e tabelës në pajtim me standardin ISO 7591 nga laboratori i akredituar.	Rezultati pozitivë në pajtim me ISO 7591 Alumin EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42, shtresa mbrapa aluminit të targës të jetë e mbrojtur me llak transparent.

Ne test raportin e dorëzuar nga MOTOR TRANSPORT INSTITUT me numër 1050/CBM/20222 datës 05.01.2023 nuk ka evidence te testimit dhe rezultat pozitivë në pajtim me ISO 7591 për Alumin EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42 dhe rrjedhimisht nuk është ne pajtueshmëri me kërkesës ne aneksin 1 te dosjes se tenderit pika 10 tek specifikat teknike.

Komisioni ri-vlerësues në dokumentacionin e dorëzuar në tenderin tuaj lidhur me pikën (*Rezultati pozitivë në pajtim me ISO 7591 Alumin EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42, shtresa mbrapa aluminit të targës të jetë e mbrojtur me llak transparent*), ka gjetur të bashkangjitur një Deklaratë nga NOVELIS, **në pajtueshmëri me nenin 59 dhe 72 të LPP-së**, kemi kërkuar që të na sqaroni, të na dorëzoni dëshmi shtesë, NOVELIS a është laborator dhe a është i akredituar në pajtueshmëri me kërkesën në njoftimin për kontratë dhe DT, nëse po na dorëzoni dëshmi.
Dokumentet duhet të jetë me datë para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohen në mënyrë objektive.

MPB-komisioni ri-vlerësues, me sqarimet e pranuara nga Ju me datë 06.09.2023 dhe 07.09.2023, keni deklaruar se NOVELIS nuk është laborator por prodhues i aluminit, citojmë "*NOVELIS është vetëm prodhues i pllakave të aluminit ndërsa testimin e ka bërë laboratori i akredituara MOTOR TRANSPORT INSTITUT*".
Kurse dëshmia tjetër e dorëzuar, nuk mund të pranohet, sepse janë në kundërshtim me nenin 72 te LPP-se, pika 3, ***dokumentet-dëshmitë duhet të jetë me datë para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve*** **dhe në kundërshtim me nenin 40.4** të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, ***asnjë ndryshim në ndonjë kusht ose aspekt material të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet,***
prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, oferta Juaj është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtutjeshëm.

Kjo çka AK ka deklaruar nuk qëndron fare sepse ne i kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë saktë ashtu siç edhe ishin kërkuar.
Arsyeja se gjoja ne nuk e kemi ofruar Test Raportin për Alumin EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42 nuk qëndron fare sepse kërkesa ishte e hartuar ndryshe. Fillimisht kërkesa tek FDT ishte e hartuar kështu:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	3. Test Raport nga Laboratori apo instituti i autorizuar i cili, duhet te dëshmoj që prodhimi i targave (mostrave) për regjistrim te automjeteve dhe karakteristikat teknike te targave janë në përputhje me standardet ISO 7591 dhe specifikimeve teknike te dosjes se tenderit.	3. Dëshmi e lëshuar nga laboratori apo instituti i autorizuar (kopje), *AK rezervon te drejten qe te kerkoi origjinalin e dokumentit me nese e konsideron te nevojshme*)

Ne e kemi dorëzuar këtë test raport saktë sipas kërkesës së AK-së por që nuk është cekur EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42. Kjo nuk është bërë sepse vet politika e laboratorit MOTOR TRANSPORT INSTITUTE nuk është e tillë që të vendosen shumë karakteristika të panevojshme për materialin e testuar. Kërkesa mandatore e FDT-së për Test Raport sipas ISO 7591 është plotësuar dhe në bazë të deklaratave të dorëzuara në tenderin tonë, tregohet se kemi të bëjmë me Aluminin EN AW 1200 H42. Se alumini i testuar është sipas standardeve EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42 shihet tek dokumenti i dorëzuar në **folderin 12** ku në dokumentet teknike të prodhuesit të aluminit (*material i cili edhe është testuar*) është e cekur se alumini i tillë është i prodhuar sipas

standardit EN AW 1200 H42. Ja si duket kjo në formën vizuale:

ADITYA BIRLA
NOVELIS

Product Description

Product : **Aluminium coils for car license plates**
Customer : **EHA Hoffmann, Siegen / Germany**
Page : **1/2**
Date : **2023-01-03**
Issue : **1 / MRe**

1. Product Description

Chromefree pre-treated aluminium coil for car license plates to be covered with retro-reflective film.

2. Metal specification

2.1 Alloy: EN AW-1200 [Al99] acc. EN 573-3

2.2 Chemical Composition:

Si	Fe	Cu	Mn	Mg	Cr	Ni	Zn	Ti	others	Al
0.07 – 0.10	0.7 – 0.9	max. 0.05	max 0.05	-	-	-	max. 0.10	max. 0.05	max. 0.15	99.0 – 99.25

(All values measured in weight %)

2.3 Temper: H42 acc. EN 1396

2.4 Mechanical properties:

Tensile strength R_m : 90 – 135 N/mm²
Proof stress $R_{p0.2}$: ≥ 70 N/mm²
Elongation A_{50} : ≥ 5 %

Nga kjo po shihet hapur se AK nuk e ka vlersuar si duhet tenderin tone dhe se nuk i ka kontrolluar saktë dokumentet e tenderit. AK qëllimisht na parashtron pyete sqaruese duke tentuar ta ngatërroj prodhuesin e aluminit "NOVELIS" me emrin e laboratorit Motor Transport Institute. Me që vet AK ka parashtruar pyetje sqaruese atëherë ne iu kemi përgjigjur duke ia dëshmuar dhe duke ja konfirmuar nga laboratori i akredituar Motor Transport Institute se dy pllakat e aluminit që janë prodhuar nga NOVELIS dhe janë testuar me kërkesë të EHA Hoffmann International GmbH janë të prodhuara sipas standardit EN AW 1200 H42. Duam të sqarojmë se test Raporti është bërë në emër të EHA Hoffmann International GmbH sepse është pikërisht kjo që ka kontratë dhe ka bërë kërkesë për testimin e pllakave të aluminit por edhe të produkteve tjera siç janë targa, folia e bardh dhe gjelbër refletuese, folia e zeze për stampim, etj. lidhur me plotsueshmërinë e standardit ISO 7591. EHA Hoffmann International GmbH nuk është prodhues i aluminit por ajo furnizohet me pllakat e tilla nga prodhuesi NOVELIS. Së bashku me kërkesën për testim drejtuar laboratorit MOTOR TRANSPORT INSTITUTE iu janë dërguar edhe fleta teknike e

prodhuesit të cilën e kemi bashkangjitur në tenderin tonë e që tregon se pllakat e tilla janë të prodhuesit NOVELIS dhe janë sipas standardit EN AW 1200 H42. Nisur nga kjo, kërkesa e AK-së shihet se ka qenë plotësisht e panevojshme pasi që në dosjen e tenderit veç ndodhen dëshmitë lidhur me pllakat e aluminit dhe standardin që AK po e konteston.

Përgjigja jonë në pyetjen sqarues ishte dhënë saktë sipas ligjit sepse ne kemi ofruar një konfirmim të laboratorit mbi llojin e materialit që AK tashmë veç e kishe si dokument të dorëzuar në tenderin tonë. Pra arsyetimi i tyre se gjoja kemi dorëzuar dokument me datë më të vonshme se hapja publike nuk qëndron sepse ne nuk kemi dorëzuar dokument por një konfirmim nga laboratori për një gjendje para ekzistuese dëshmitë e të cilës i kemi dorëzuar në tenderin tonë.

Neni 72 shumë qartë e thotë se:

Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Pra po shihet se ne kemi ofruar një sqarim për një gjendje dhe një dokument që ka ekzistuar para hapje publike, mban datën 05.01.2023 dhe ndodhet i dorëzuar së bashku me tenderin tonë. Ja si duket dokumenti për të cilin ne kemi ofruar sqarimin:

ADITYA BIRLA
NOVELIS

EHA Hoffmann
International GmbH
Michelsbergstr. 24

57080 Siegen

05.January 2023

TENDER KOSOVO Motor Vehicle License Plates and Equipment, Tender No. 214-22-12927-1-1-1"

Dear Mr. Ginter,

we confirm that Novelis Deutschland GmbH will supply EHA Hoffmann International GmbH with pre-treated aluminium coils for production of car license plates for the a.m. tender in specification EN AW-1200, H 42, both sides chrome pre-treatment, one side coated with protective lacquer.

The material fulfils the requirements for EN 14069 and ISO 7591 (copy of test certificate included).

Details of a supply contract between EHA Hoffmann International GmbH and Novelis Deutschland GmbH like price, quantity and other parameters will be subject to a separate agreement.

Novelis Deutschland GmbH
Werk Göttingen

Best Regards
Novelis Deutschland GmbH
Werk Göttingen

Përpos së gjithash ky dokument mund të verifikohet qartë dhe objektivisht sepse njëjti ndodhet në tenderin e dorëzuar nga ne. Pra sipas kësaj arsyetimi se Test Raporti nuk është i

kompletuar dhe alumini nuk është sipas standardit EN AW 1200 H42 nuk qëndron fare dhe vlerësimi i AK-së duke na cilësuar si të papërgjegjshëm është në kundërshtim të plotë me nenin 59 të LPP-së.

Edhe ajo që AK po mundohet të na vë në lajthitje duke e ngatërruar prodhuesin e pllakave me prodhuesin e tabelave si dhe duke tentuar që prodhuesin e pllakave ta konsideroj si laborator testues, është plotësisht jo ligjore madje edhe jo etike. Test Raporti është dashur të jetë adresuar prodhuesit të tabelës dhe ashtu e kemi dorëzuar ne sepse prodhues i tabelës është vet EHA Hoffmann International GmbH ndërsa NOVELIS është prodhues vetëm i pllakës së aluminit. Ngjashëm me këtë i bie sikur testojmë folien e prodhuesit 3M apo shtresën për stampim të nxehtë që është e prodhuesit API.

Pra nga krejt kjo po shihet se konfirmimi i dorëzuar nga ne edhe pse posedon datën më të vonshme se hapja publike, ai nuk është dokument por një konfirmim që tregon se pllakat e aluminit janë sipas standardit EN AW 1200 H42 dhe se kjo vetëm e përshkruan dokumentin/fletën teknike të pllakave të aluminit që posedojnë datën 05.01.2023 e që janë testuar para datës së hapjes publike. Pra nuk kemi të bëjmë me dokument por me konfirmim të asaj që AK ka kërkuar si sqarim për pasojë të asaj që nuk ka arritur ta kuptoj nga dështmitë që i kishte tek tenderi jonë.

Sipas kësaj del që ne e kemi dorëzuar Tast Raportin saktë sipas kërkesave të dosjes së tenderit, jemi tenderues plotësisht i përgjegjshëm dhe që posedojmë çmimin më të ulët nga tenderuesit tjerë të përgjegjshëm e edhe në krahasim me Grupin e OE të shpallur fitues i cili në të njëjtën kohë është i papërgjegjshëm.

Përpos krejt kësaj, është i çuditshëm fakti që komisioni i vlerësimit të tenderëve ka rekomanduar që tenderi duhet anuluar ndërsa Zyrtari Kryesor i Prokurimit pa e ndryshuar fare komisionin e vlerësimit, e merr vet vendimin dhe e përzgjedhë si fitues Grupin e OE EGO ELSA SHPK & Rade Koncar - kontaktori i relei d.o.o. Kjo konsiderohet shkelje e plotë e procedurave administrative dhe njëkohësisht është në kundërshtim edhe me kodin etik pasi që shihet hapur se Zyrtari Kryesor i Prokurimit ka bërë tejkalim të kompetencave

të përcaktuara me ligj. Kjo e vërteton edhe më shumë faktin që AK ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së gjatë përzgjedhjes së OE fitues.

Pretendimi 6: AK ka shkelur 60 të LPP-së pasi që si pasoj e asaj që nuk ka respektuar nenet tjera që kishin të bënin me vlerësimin dhe sqarimin e tenderëve ka ardhur deri te shkelja edhe e nenit në fjalë ku ka shpërblyer me kontratë një Grup të OE që nuk është i përgjegjshëm dhe posedon çmimin dukshëm më të lartë se kompania jonë. Këtu shihet qartë se nuk është respektuar kriteri tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët e që ishte dashur që me kontratë të shpërblehet kompania jonë.

Pretendimi 7: AK ka shkelur 69 të LPP-së pasi që edhe për kundër që ka kërkuar certifikata lidhur me përgatitjen profesionale të OE, ato nuk i ka respektuar dhe nuk i ka trajtuar si duhet. Grupi i OE i cili është shpallur fitues nuk posedon si të rregullta një mori dëshmish që i kemi cekur edhe ne pretendimet paraprake andaj me plot kuptim deklarojmë se AK nuk ka respektuar nenin 69 të LPP-së lidhur me aftësitë teknike dhe profesionale të OE.

Pretendimi 8: AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së pasi që gjatë sqarimit të tenderëve ka tentuar të na vë në lajthitje dhe se nuk i ka pranuar sqarimet e ofruara nga ne si të rregullta edhe pse ato ishin saktë sipas nenit 72 të LPP-së. AK në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së dhe në kundërshtim edhe me nenin 38 të RPP-001/2022 po tenton të na e zhvleftësoj sqarim e ofruar nga ne duke e konsideruar si dokument dhe duke e atakuar kinse tek data e më vonshme se ajo e hapjes publike. Me që konfirmimi i Laboratorit nuk konsiderohet dokument dhe se i njëjti fletë për gjendjen para ekzistuese se data e hapjes publike, tregon se sqarimi i tillë është në rregull. Bazuar në gjendjen e tenderit tonë, veprimi i tillë i AK-së bie ndesh plotësisht me nenin 72 të LPP-së dhe me nenin 38 të RRPP-001/2022.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdes ankesën tonë kundër vendimit të AK-së dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar duke marr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e Grupit të OE "TSR SHPK & EHA Hoffmann

International GmbH" lidhur me tenderin "Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve" i iniciuar nga MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.

ANULOHET njoftimi mbi Vendimin i AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME dhe lënda të kthehet në Ri-Vlerësim.

Ri-Vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e LPP-së dhe RRPP-001/2022 si dhe ato nga dosja e tenderit ku më pas fitues do duhej që të shpallej Grupi i OE "TSR SHPK &

EHA Hoffmann International GmbH".

KRITERET PËR VLERËSIM

			Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

			a.Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Nenin 65 të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L- 068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.	a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit, Aneksi 2 (Origjinal).

			b.Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.	b.Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Vertetimit nga administrata tatimore, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar.

			c.Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit, që vërteton se tenderuesi i përmbush "Kërkesat e pranueshmërisë" për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, i cili duhet të jetë jo me i vjetër se 3 muaj para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.	c.Vërtetimin nga Gjykata Themelore- Departamenti për Çështje Ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të operatorit ekonomik (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Vërtetimin nga Gjykata perkatëse, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar.

	Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale a.Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit me Informata mbi biznesin dhe veprimtaritë. Për Operatorin Ekonomik jo rezident ne Kosove, nëse shpërblehet me kontratë, para nënshkrimit te kontratës, është i obliguar qe ta regjistrojnë përfaqësinë e biznesit ne Republikën e Kosovës.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* a.Certifikatë e regjistrimit të biznesit, me informata dhe veprimtaritë e biznesit (kopje).
			b.Deklarues i TVSH-së, (për kompanitë vendore).	b.Certifikata e TVSH-së (kopje).
	Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar a.Operatori ekonomik duhet te ofroje dëshmi te kënaqshme Autoritetit kontraktues, se qarkullimi vjetor financiar i OE i realizuar në tri vitet e shkuara 2019-2020-2021 kanë qenë jo me pak se 3,000,000.00 €.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* a. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore ose nga vendi i origjinës (kopje).
	Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional 1.Operatoret ekonomik pjesëmarrës, duhet të kenë kontratë/a të përfunduara me sukses për furnizim me targa për regjistrim të automjeteve, shuma e të cilave kanë qenë në vlerë jo me pak se 500,000.00 € , të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 1. Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Listës duhet ti bashkëngjiten dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i furnizimeve për kontratat dhe projektet e cekura në listë, (kopje).

			2.Operatori ekonomik është i obliguar që për targat me të cilat ofertojnë duhen ta dorëzojnë një mostër të targës së rëndomtë e cila është në përdorim, me dimensione 520 x 110 mm së bashku me përshkrimin e specifikimeve teknike. Nëse nuk dorëzohet mostra dhe përshkrimi i specifikimeve teknike te mostrës oferta nuk do te merret ne shqyrtim dhe do te konsiderohet oferte e pa përgjegjshme. Mostra nuk është e obligueshme që ti kenë masat e veçanta të sigurisë, por duhet jenë ne harmoni me kualitetin e materialeve për prodhimin e targave sipas specifikave teknike te dhëna ne Aneksin 1 të Dosjes së tenderit.	2. Një mostër të targës me dimensione 520 x 110mm, sipas specifikimeve teknike- MOSTRA e targave dorëzohen fizikisht para hapjes se ofertave, në një zarf të mbyllur.
			3. Test Raport nga Laboratori apo instituti i autorizuar i cili, duhet te dështmoj që prodhimi i targave (mostrave) për regjistrim te automjeteve dhe karakteristikat teknike te targave janë në përputhje me standardet ISO 7591 dhe specifikimeve teknike te dosjes se tenderit.	3. Dështmi e lëshuar nga laboratori apo instituti i autorizuar (kopje), *AK rezervon te drejten qe te kerkoi origjinalin e dokumentit me nese e konsideron te nevojshme*)
			4. Laboratori/institute i cili leshon test raportin sipas kerkesen ne nenin 9.1 & 9.2 te pikes 3, duhet te jete i akredituar nga institucionet perkatse dhe te jete i pranuar/antarsuar së paku një nga këto organizatat: - Kooperimi Evropian për Akreditim (EA) - Kooperimi ndërkombëtar laboratorik për akreditim (ILAC) - Forumi ndërkombëtar për akreditim (IAF).	4. Çertifikatë ose dokument tjetër dështmues (kopje) *AK rezervon te drejten qe te kerkoi origjinalin e dokumentit me nese e konsideron te nevojshme*)
			5.Dështmi me të cilën dështmohet që folia dhe ngjyra e shkronjave është kompatibile në pajtim me ISO 7591.	5. Çertifikatë ose dokument tjetër dështmues (kopje), *AK rezervon te drejten qe te kerkoi origjinalin e dokumentit me nese e*

				konsideron te nevojshme).
			6.Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatën valide ISO Standard 7591 për prodhimin e targave retro-reflektive për automjete motorike dhe rimorkio (Retro-reflective registration plates for motor vehicles and trailers).	6. Certifikatën valide ISO Standard 7591 (kopje)
			7.Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatën valide ISO Standard 9001 për menaxhim cilësor te sistemeve (Quality manage systems)	7.Çertifikatë valide ISO 9001 (kopje)
			8.Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatën valide ISO Standard 14001 për Sistemet e menaxhimit mjedisor (Environmental management systems).	8.Çertifikatë valide ISO 14001 (kopje)
			9. Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatën valide ISO Standard 27001 për menaxhim te sigurisë se informacionit (Information security management).	9. Çertifikatë valide ISO 27001 (kopje)
	Ankesat	32.3	Shëno adresën e AK-së. Referoju nenin 1.1 ne FTD	

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **TSR SH.P.K.**

Sqarim hyrës: OE ankues përmes ankesës ka ngritur një numër të pretendimeve ankimore, të cilat pretendime në vazhdim do ti ndajmë në dy grupe, pretendimet ankimore të OE mbi arsyet e eliminimit të tij, si dhe pretendimet ankimorë kundrejt OE të rekomanduar për kontratë. Vlen të theksohet se OE I rekomanduar për kontratë është me çmim më të lartë se OE ankues.

Pretendimi nr.1

Arsyeja kryesore e eliminimit të OE ankues sipas AK-së është se ky OE nuk ka ofruar dështmitë në pajtim me kërkesat e dosjes. Konkretisht AK pretendon se raporti I testimit me rezultat pozitiv sipas standardit ISO 7591 për Alumin 1050 H42 ose EN AË 1200 H42.

Po ashtu AK pretendon se dështmitë nga Novelis janë të papranueshme pasi I njëjti nuk është laborator, dhe dështmitë shtesë tjera janë e me datë pas hapjes dhe si të tilla janë të papranueshme.

OE pretendon se I njëjti ka ofruar raportin e testimit në pajtim me standardin ISO 7591, dhe po ashtu se I njëjti ka ofruar deklaratë/përshkrimit ë produktit nga prodhuesi I shiritave metalik/alumin Novelis se të njëjtit furnizojmë kompaninë EHA (Anëtar I grupit të OE) me materialin adekuat Alumin EN AË 1200 H42.

Pas analizimit të dosjes së tenderit, pretendimeve ankimore të OE ankues, dhe njoftimit mbi vendimin e AK-së, vlerësojmë se pretendimi ankimorë I OE ankues në këtë pikë është I bazuar.

OE ankues në ofertën e tij ka ofruar dështmi raportin testues në pajtim me standardin ISO 7591 ashtu si është kërkuar nga AK.

Po ashtu OE ankues në ofertë ka bashkangjitur dështmi nga prodhuesi I shiritave te aluminit Novelis se të njëjtit e furnizojnë kompaninë EHA (anëtar I grupit të OE ankues) me alumin EN AË 1200 H42.

Fakti që në raport testues të mungon një detaj si në rastin konkret "EN AË 1200 H42" nuk nënkupton se produkti nuk e plotëson ose nuk është I përberë nga ky material.

Kjo është konfirmuar nga vet prodhuesi I aluminit NOVELIS se të njëjti t e furnizojnë anëtarin e grupit të OE ankues me shirita të aluminit EN AË 1200 H42.

Po ashtu arsyetimi i AK-së se dështmitë tjera gjatë vlerësimit janë të papranueshme pasi kanë datë pas hapjes së ofertave, vlerësojmë se është arsyetim i pabazuar pasi këto dokumente dështmi shtesë nuk kanë për qëllim zëvendësimin e dokumentit ekzistues po sqarimin e të njëjtit, dhe dokumenti për të cilin ofrohen sqarimet ka ekzistuar para hapjes së ofertave.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore në këtë pikë janë të bazuara.

Pretendimi nr.2

Pretendimet e OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë sa i përket mostrave, ku OE ankues pretendon se mostra e OE fitues shiritat nuk e kanë shkronjat RKS, se shkronja janë shtyp me Sito Shtypje, se shkronja RKS majtas mungojnë, për gjitha këto pretendime ankimore eksperti nuk mund të jap përgjigje pasi i njëjti nuk ka kapacitet teknik/profesional, dhe analiza e mostrave është bërë nga Fakulteti teknik, çka ka qenë kërkesë e OSHP-së përmes vendimit paraprak.

Vlerësimi i ekspertit është se rezultat e dala nga Fakulteti teknik duhet të konsiderohen të pakontestueshme, pasi vet OSHP ka përcaktuar përmes vendimit që pas analizës/rezultateve të Agjencionit të Forenzikës mostrat duhet të testohen edhe një here.

OE po ashtu pretendon se AK ka ndërruar dëshmitë me rastin e dërgimit të mostrave nga Agjencdioni i forenzikës në Fakultet teknik, dhe se kjo përbën vepër penale.

Eksperti shqyrtues sqaron se edhe në këtë pikë nuk kemi kapacitet e as kompetencë/autorizim për të trajtuar një pretendim të tillë, dhe në rast se OE ankues është i bindur se veprime të tilla kanë ndodhuri njëjti rastin mund ta paraqes pranë organeve kompetente.

OE ankues po ashtu pretendon se i është dhënë qasje e kufizuar në dokumente të OE fitues, dhe dyshon se OE fitues nuk i ka plotësuar kërkesat për Raport të testimit.

Fillimisht duhet të cekim se pajtohemi në parim me OE ankues pasi dokumente si ISO standardet apo edhe raportet e testimit kanë mundur së paku ti ofrohen OE ankues në formë të spastruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Sa i përket pretendimit se OE fitues i mungon raporti i testimit në pajtim me kërkesa e dosjes, pa dashur të zbulojmë vet dokumentin në fjalë, sqarojmë se të njëjtin e kemi analizuar dhe konfirmojmë se është në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

Po ashtu OE ankues ka ofruar dëshmi që anëtari i grupit të OE fitues ka kërkuar nga anëtari i grupit të OE ankues furnizim me targa po për këtë aktivitet të prokurimit, me çka OE pretendon se dëshmohet se OE i rekomanduar nuk ka kapacitet teknik/profesional për prodhimin e këtyre targave. Për këtë pretendim OE ankues ka ofruar emailat korrespodencat mes kompanive në fjalë.

Të njëjtat dëshmi gjenden në ankesë të OE ankues dhe paneli shqyrtues mund ti marr parasysh gjatë vlerësimit të lëndës dhe vendim marrjes.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **TSR SH.P.K.**

Ilir Halili